

	KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	---	---

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - SUHAREKË

Nr. Protokollit	03/ 2025
Vendi i takimit:	Salla e Bordit të Drejtorëve
Datë:	17.06.2025

PROCESVERBAL

Nga takimi i Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive “KKSB” - Suharekë të paraparë sipas Udhëzimit Administrativ të nënshkruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Nr-27/2012, dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr-03/2012, për themelimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi (KKSB).

Takimi filloi në ora 10.00

Në takim morën pjesë :

Afrim Sylaj - Komandant në Stacionin Policor në Therandë

Haki Hoxha - përfaqësues i Komunitetit Islam

Albert Demaj - përfaqësues i Komunitetit Katolik

Enver Shabani - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë

Bashkim Gashi - përfaqësues e EVSB-së

Remzi Bajselmani - Drejtor i Drejtorisë së Arsimit

Habibe Bytyqi - Zyrtare për Barazi Gjinore

Albestrim Rexhepi - përfaqësues i FSK-së

Drilon Zyba - përfaqësues i KLSP-së

Adem Derguti - Kryetar i KPAK-së

Rozeta Jahaj - përfaqësuese e OJQ-ve

Refki Zogaj - përfaqësues i Komunitetit të Biznesit

Euro Linda Zenelaj - përfaqësuese e Mediave lokale

Xheladin Sadikaj - përfaqësues i zyrës KKK-së

Qëndresa Baftjaraj - përfaqësuese e KPAK-së

Myrvete Shala - përfaqësuese e Shqiptarëve

Denis Sofra - Kryesues i KK-së dhe përfaqësues i KA-li

Zekë Berisha - përfaqësues i Romëve

Nazim Shabanaj - përfaqësues i Egjiptasve

Mbledhjen e hapi Nënkrjetarja e Komunës e cila i njoftoi me rendin e ditës.

Rend dite

- 1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturanët;**
- 3. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm;**
- 4. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtjen nga zjarri gjatë sezonit veror;**
- 5. Identifikimi i hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lirë e qytetarëve;**

Nënkrjetarja - e hedh në votim rendin e ditës.

Aprovohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Nënkrjetarja - e hedh në votim pikën 1.

Aprovohet pika 1

Pika 3. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm;

Nënkrjetarja - jemi në sezonin e verës ku edhe ardhja e qytetarëve tonë nga diaspora e bëjnë fluksin më të madh të njerëzve dhe natyrisht lokalet e natës janë të frekuentuara me shumë njerëz, andaj ruajtja e rendit dhe qetësisë publike është thelbësore për mirëqenien e sigurisë së qytetarëve tonë.

Afrim Sylaj - ne jemi në një fazë kur kemi shumë raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike. Duke u bazu në dy vitet e mëparshme, ne kemi disa lokacione ku prishet rendi dhe qetësia publike. Është sheshi ku kemi pas shumë thirrje telefonike dy vitet e fundit, pastaj kemi pas një kafiteri e cila fatmirësisht nuk është më funksionale sikurse vitet tjera, është Qebar. Kemi edhe kafiterinë Monun dhe disa kafiteri tjera. Aty ku bëhen shkeljet e rendit dhe qetësisë publike, ne kemi intervenu dhe kemi lëshu gjoba vazhdimisht por ajo që kërkojmë ne si polici e Kosovës është që nga muaji korrik dhe gusht të kemi kujdestari edhe pas orës 16:00 nga inspektorët komunal që bashkë me policinë të bashkëveprojnë në teren për arsye se ne kemi mungesë të aparateve për matjen e zërimit e cila është e domosdoshme me ligj. Dua të ju njoftoj që dy lokalet e natës në Duhël dhe Topliqan janë funksionale jasht orës 24:00. Ne nuk kemi asnjë lokal që me funksionu jasht orës 24:00 dhe nëse është mundësia që këto dy lokale në Duhël dhe Topliqan nëse nuk i përmbushin kriteret, na njoftoni ju si komunë që ne të marrim masa dhe ti mbyllim ato lokale.

Drilon Zyba - vëtetë është i domosdoshëm ky aktivitet por jo vetëm në sezonë por edhe jasht sezonës. Në mbledhjen e kaluar është diskutu për punën e dhënies në shfrytëzim të sheshit. E di që kanë dale disa foto por gjendja në teren nuk ka ndryshu. Ne mundemi me mbajtë mbledhje vazhdimisht por a po ndryshohen apo s'po ndryshohen hiq? Pajtohem që duhet me qenë tolerant për shkak të sezonës por jo edhe ndaj pengesës së atyre të verbërve, të cilin projekt vet e ka bërë komuna. Komandanti përmendi dy lokale dhe unë kam njohuri që janë intervenu para dy javë mbi to. Te prishja e rendit dhe qetësisë e kemi problemin në krejt komunën dhe jo vetëm në 2-3 lokale. Ka dy vite që diskutohet për Qebarin dhe kam kërku nga komandanti të di se sa here e ke denu Qebarin dhe sa here e ke denu Infinitin dhe por si ke sjell përgjigjet.

Nënkrjetarja - sa i përket sheshit, secili lokal është i njoftuar nga komuna që ti përmbahen rregullave sa i përket shfrytëzimit të sheshit. Në takimin e bordit kemi biseduar që të vendoset një vijë e kuqe që mos të kalojnë me karrige për arsye që qytetarët të lëvizin lirshëm. Pra masat merren dhe sheshi është në rregull përpos këtyre punime që nuk janë përfund. Sa i përket të verbërve, është një projekt që brenda javës apo muajit nuk mund të bëhet dhe nuk jemi edhe keq me pjerrina.

Afrim Sylaj - në rastin e Qebarit, nuk kemi ankesa. Te Infiniti, sa here kërkohet ne gjithmonë reagojmë dhe japim gjoba. Tash në sezonë kemi më shumë prishje të rendit dhe qetësisë publike sepse tash kemi ahengje dhe festime në qytet dhe nuk mund ti parandalojmë sepse vendimet i merr Kuvendi komunal dhe ne e zbatojmë vendimin.

Drilon Zyba - unë nuk e ceka që vazhdon por para dy viteve është diskutu.A mund ta sjellësh mbledhjen tjetër se sa here e ke denu Qebarin dhe sa here e ke denu Infinitin.

Afrim Sylaj - po.Ne nuk kemi aparat për matjen e zërimit dhe kemi pas problem edhe në shqiptimin e gjobave.Ne kemi kërku edhe ndihmë prej Prishtinës,nuk kanë aparat.Duhet ta dini që është bë punë,ka gjoba.

Eurolinda Zenelaj - nuk e di sa i përcjell Driloni mediat lokale por ne e kemi pas një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me policinë,sidomos në sezonën e verës dhe i falemderoj.Sa here i kam thirr policinë,janë përgjigj gjithmonë,sidomos për prishjen e rendit dhe qetësisë publike neve na kanë dërgu të dhënat gjithmonë dhe për gjoba ne kemi shkru edhe artikuj që shumë lokale në Suharekë janë gjobit.

Rekomandim: të jetë bashkëpunimi në mes Drejtorisë së Inspeksionit dhe policisë dhe kur do herë qytetarët dhe në këtë rast anëtarët e KKSB-së që kanë informacione për prishjen e rendit dhe qetësisë publike,t'í njoftojnë organet kompetente.

Avni Bytyqi - ideja dhe qëllimi i Komunës dhe i policisë është që të vetëdijesohen qytetarët dhe bizneset por të jemi gjithmonë në shërbim të qytetarëve dhe të krijojmë kushte ku qytetarët të jenë të lire dhe të qetë. Unë jam kundra e asaj që u tha se sa ke shqiptuar gjoba sepse nganjëherë nuk krijon efekt pozitiv shqiptimi i gjobave X lokalit. Po ju njoftoj që komuna e ka një rregullore për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës e cila e përcakton shumë saktë fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për secilin lokal dhe kush është organ kompetentë për ta zbatuar atë rregullore. Në këtë rast organ kompetentë për ta zbatuar rregulloren janë policia e Kosovës dhe Inspektoriat i Komunës.

Drilon Zyba - edhe unë s'mendoj që me herën e parë me denu por vërejtja sugjerimi ka shumë përpara. Unë vetëm kërkova nga komandanti vetë një përgjigje.

Avni Bytyqi - besoj që të gjitha gjobat që shqiptohen janë transparente dhe publike përpos të dhënave personale.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 2. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maturantët;

Remzi Bajselmani - ne si DKA në kordinim me kalendarin e Ministrisë së Arsimit për përfundimin e vitit mësimor jemi në fazën e fundit dhe kjo është java e fundit për këtë vit mësimor. Sa i përket maturantëve, ekskursionet i kanë realizua tri shkollat e mesme në Shqipëri dhe çdo gjë ka shku në rregull. Po ashtu kanë organizuar mbrëmjet e maturës të cilat i kanë realizu në mënyrë modeste dhe në përgjithësi matura ka rrjedh mirë,pa asnjë incident.Tani jemi në fazën e përgatitjeve të testit të maturës i cili do të realizohet me 21 qershor. Kemi informacione prej tri shkollave se është gjenerata më e mirë në 10 vitet e fundit. Edhe shkollat e mesme të ulëta,klasat e nënta testin e arritshmërisë do ta mbajnë me 27 qershor dhe besojmë që edhe ata do të dalin mirë.

Nënkryetarja - sa është numri i maturantave?

Remzi Bajselmani - 670 maturantë kurse semimaturantë janë 654.

Avni Bytyqi - edhe vitin e kaluar ka pas fjalë të mira për organizimet dhe aktivitetet nga DKA,atëherë të dalim me rekomandim.

Rekomandim: të vazhdohet me organizime të tilla.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin.

Aprovohet rekomandimi

Pika 4. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtjen nga zjarri gjatë sezonit veror;

Nënkryetarja - Drejtori i DSHPE nuk mund të ishte i pranishëm në takim mirëpo informatat mi dha mua. Sezioni veror jo vetëm që sjell temperatura të larta por është edhe rrezik i shtuar nga zjarret andaj ne si komunë përkatësisht DSHPE gjithëherë jemi vigjilent. Si komunë e kemi një plan të veprimit në parandalimin e zjarreve por sfida është numri i zjarrfikëseve edhe pse është rrit numri për 4 zjarrfikës mirëpo jemi duke u përgatitë me shtu numrin edhe të zjarrfikëseve të tjerë. Mjete kemi mjaft për arsye se kemi marrë shumë donacione.

Afrim Sylaj - dua të theksoj që stacioni policor i Suharekës ka hetu dhe ka inicu 17 raste të zjarreve. Këtë vit vetëm deri në muajin maj kemi 8 raste duke përfshirë edhe 3 raste në qershor. Kompetentë të zjarreve dhe ekspertë janë dikush tjetër dhe policia i heton kryesisht e veprave penale ose shkaktarët e zjarreve. Unë kërkoj nga të gjithë që të japin kontribut në parandalimin e zjarreve dhe të dilet me apele për qytetarët që mos të shkaktojnë zjarre pa nevojë. Me ligj është e përcaktuar që ndezja e zjarreve në vende publike është e dënueshme dhe ne vazhdimisht kemi dhënë edhe gjoba. Ne si polici do të reagojmë mirëpo do të ishte mire që t'kemi njerëz të përcaktuar, që dy muajt e ardhshëm të jenë jenë të gatshëm t'ju ndihmojnë zjarrfikësëve me qëllim që mos të ballafaqohemi me incidente të rënda e që mund të rrezikohemi.

Drilon Zyba - I përgëzoj zjarrfikësat. OSBE ka bërë financimin e disa projekteve dhe ne si KLSP jemi një nga 8 përfituesit. Në projekt janë 40 qanta për fikjen e zjarrit me dorë, 40 maska kundër tymit dhe 10 qanta për ndihmë të parë dhe ideja është ti lëmë nëpër shkollat: Bukosh, Vraniq dhe Savrovë që ndihma e parë me qenë aty për çdo organizim. Janë mjete afatgjate.

Rozeta Jahaj - sfida tjetër është që ne nuk kemi shumë informacione se si mundemi me parandalu një zjarr dhe mendoj që do të ishte mire që në qofte se prej drejtorisë, edhe prej qytetarëve me u mbajte një ligjëratë nëpër fshatra ose në qytet që të informohen qytetarët, që deri në intervenimin e zjarrfikësave si mundemi me parandaluar ardhjen e një zjarri.

Nënkryetarja - ide e qëlluar dhe ndoshta është mire edhe nëpër shkolla me mbajte, me fillu prej shtatorit.

Rekomandim 1: Komuna të del me një apel për të gjithë qytetarët që të ketë kujdes gjatë kësaj periudhe në çështjen e ndezjeve të zjarreve, sidomos në ndezjen e

Rekomandim 2: Të njoftohen nga DSHPE të gjitha pishinat që në rast nevojë njesiti i zjarrfikësave të kenë të drejtë që në pishinat e tyre të furnizohen me ujë.

Rekomandim 3: Të bëhet organizimi për angazhimin e zjarrfikësave vullnetar përmes kryetarëve të fshatrave dhe pse jo edhe përmes KLSP-së siç u përmend një projekt i rëndësishëm nga Driloni.

Avni Bytyqi - Driloni përmendi një projekt të rëndësishëm të KLSP-së dhe pse jo KLSP-ja ta bëj një projekt të tillë dhe ta sjell në komunë. Komuna është e gatshme që të financoj projektet të tilla. Agjensioni për menaxhimin e emergjencave vazhdimisht organizon trajnime për çështjen e zjarrfikësave, për njerëz që kanë vullnet të mirë për t'ju ndihmuar zjarrfikësave kur të paraqitet nevoja dhe rreziku për qytetarët. Jemi të gatshëm për ata që vërtetë janë të organizuar dhe certifikohen nga AME dhe tregohen të angazhuar në çështjen e fikjeve të zjarreve, jemi të gatshëm që ti lirojmë nga të gjitha shërbimet e QKMF-së dhe nga të gjitha shërbimet që ofrohen në komunë të cilat janë kompetencë e komunës.

Drilon Zyba - në rastin e vullnetarëve të cilët punojnë te x kompania private, a mundet komuna nëse është organ kompetent sepse këtë nuk e di, me fut në funksion që personave vullnetar të ndalohet puna përkatëse për një javë ose dy javë dhe ata persona të inkuadrohen në shuarjen e zjarreve, dhe prap personat vullnetar të kthehn në vend të punës?

Avni Bytyqi - një gjë të tillë nuk e lejon ligji por një gjë të tillë mund ta bëjmë me marrëveshje bashkëpunimi dhe të mirëkuptimit edhe me kompanitë private ku punojnë, por jo me javë të tëra sepse zjarri askund nuk zgjat me javë të tëra, ajo mund të jetë afekt 3-5 orë dhe besoj për këto orë komuna mund të arrij marrëveshje bashkëpunimi me qendrën e biznesit për ata që janë të licencuar dhe profesional për

çështjen e fikjes së zjarreve të lirohen nga vendi i punës për një ditë ose 4-5 orë dhe besoj që askush nuk i ndalon për një veprim të tillë.

Nënkryetarja - i hedh në votim rekomandimet.

Aprovohen rekomandimet

Pika 5. Identifikimi i hapësirave publike ku cenohet lëvizja e lirë e qytetarëve;

Nënkryetarja - si komunë jemi kujdes që të kemi trotuare të mjaftueshme, jo vetëm në qendër por në të gjitha fshatrat, pastaj parkingje mirëpo për shkak të punimeve kemi pas edhe pengesa për qytetarët. Kemi pak problem te sheshi për shkak se ende nuk janë përfunduar punimet por punët janë në përfundim e sipër.

Afrim Sylaj - sheshet janë ndërtu shumë mirë por vazhdimisht kërkesa e policisë ka qenë që të vendosen shenja adekuate se sa kanë të drejtë me i shfrytëzuar lokalet hapësirën publike sepse nëse vazhdojnë me u vendos karrige do ta bllokohet sheshi. Në hapësirat publike, çdo kund ku ne hasim, ne do të intervenojmë si polici mirëpo te bizneset kemi problem sepse nuk i dinë këto rregulla dhe nëse i vendosim shenjat identifikuese, ne mund ta japim kontributin si polici.

Nënkryetarja - e thashë që ne e kemi pas një takim me Kryetarin, me Drejtojnë e Inspeksionit dhe me Drejtorinë e Urbanizmit dhe kemi dërgu urdhëresa nëpër të gjitha lokalet. Nëse nuk i respektojnë urdhëresat do të vendoset një vijë e kuqe orientuese dhe të gjitha lokalet që e kalojnë do të ndëshkohen.

Eurolinda Zenelaj - a e keni cek një afat kohor sa keni me përcjell a po respektohet apo jo? sepse nëse merret ajo vija e kuqe në fund të gushtit, mendoj që është e padobishme.

Avni Bytyqi - urdhëresën të cilën e ka lëshu Kryetari i Komunës ka të bëjë për mirëmbajtjen e hapësirave publike përrreth lokaleve. Ajo ka një afat prej 8 ditësh dhe do ta përcjell inspeksioni vazhdimisht dhe jo vetëm në afat prej 8 ditësh. Ndërsa çështja e shfrytëzimit të hapësirave publike është temë e cila rregullohet me një rregullore apo me një vendim të komunës që ju krijon mundësi, që të gjitha bizneset që kanë interes ta marrin në shfrytëzim hapësirën para lokalit, ju jepet me pagesë mirëpo duke mos cenuar lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Drilon Zyba - unë mendoj që ne me dhënë një rekomandim nga këtu, që javën ardhshme me dal inspektoriati në teren çdo ditë.

Avni Bytyqi - propozimi është i mirë por secila drejtori i ka planet e veta të punës, detyrat dhe raportet e veta, të cilat i raportojnë te eprori i vete dhe nuk do të thotë që ne ta caktojmë inspeksionin në një fushë të caktuar dhe të lëmë diçka keq. Ne do dalim me rekomandim.

Drilon Zyba - unë them që inspeksioni me pas fokusin kryesor tek hapësirat publike një javë.

Rekomandim 1 : Drejtoria e Inspeksionit në bashkëpunim me policinë të marrin veprime që të lirojnë hapësirat publike me qëllim që t'ju lejohe lëvizja e lirë e qytetarëve.

Rekomandim 2: Inspeksioni të del në teren dhe ti vizitoj bizneset çdo ditë për një javë.

Haki Hoxha - unë mendoj që është mirë të vendosen shiritat e pastaj inspeksioni ti kontrolloj lokalet.

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin 1.

Aprovohet rekomandimi 1

Nënkryetarja - e hedh në votim rekomandimin 2

Nuk aprovohet rekomandimi 2